

*W
R*

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/37

Prishtinë,më 22 dhjetor 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

PROCES VERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesuese ishte Nafije Gash,anëtare e Kryesisë.

Kryetari konstatai se në seancë ishin të pranishëm 98 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligit për buxhetin vjetor të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2003.

Sabri Hamiti,në emër të Grupit parlamentar të LDK-së,kërkoi që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë një deklaratë kundër organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Serbisë në territorin e Kosovës.

Ismail Kurteshi theskoi se Grupi Parlamentar i PDK-së,në seancën e mëparshme, ka kërkuar që Kuvendi,në seancën e sotme të deklarohet,përmes një deklarate, kundër organizimit dhe mbajtjes të zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, theksoi se i pëkrah kërkesat e dy grupeve parlamentare që Kuvendi të deklarohet kundër organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës. Ai shprehu shqetësimet e këtij grupi parlamentar që Kuvendi, gjatë viti 2003, nuk e ka realizuar kërkesën e 42 deputetëve për shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur dhe kërkoi që ajo të realizohet në fillim të vitit 2004.

Dragisha Krstoviq theksoi se Grupi Parlamentar "Kthimi" edhe në seancën e mëparshme është deklaruar kundër nismës së tri grupeve parlamentare lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në Serbi dhe që kanë të bëjnë edhe në territorin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës nuk mund të merret me zgjedhjet e Serbisë, ngase sipas tij, kompetent lidhur me këto zgjedhje janë OSBE-ja dhe subjektet juridike ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, por ata nuk kanë reaguar kundër këtyre zgjedhjeve.

Kryetari theksoi se Kryesia e ka shqyrtauar kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me këtë çështje dhe njëzëri ka vendosur që Kuvendi ta miratojë një deklaratë, të hartuar nga Kryesia, lidhur me zgjedhjet e Serbisë në territorin e Kosovës. Ai kërkoi mbështetjen e kësaj nisme edhe nga grupet e tjera parlamentare.

Kryetari konstatoi se shumica e grupeve parlamentare dhe Kryesia e Kuvendit e përkrahin kërkesën e Grupit parlamentar të PDK-së lidhur me organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës dhe vendosi që ajo të vihet në rend dite të kësaj seance.

Deputetët e Grupit Parlamentar "Kthimi" në shenjë pakënaqësie e lëshuan seancën.

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbal i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për buxhetin vjetor të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2003.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij p/ligji, si dhe për raportet dhe rekomandimet e Komisionit të Buxhetit dhe të Komisionit për Ekonomi dhe Financa.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e komisioneve të lartëpërmendura.

Kuvendi, me shumicë votash, i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13.

Kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----0;
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2003.

3. Shqyrti i organizimit dhe i mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës.

Kryetari e ftoi anëtarin e Kryesisë, Fatmir Sejdiu, t'ia paraqiste Kuvendit tekstin e Projektdeklaratës, të hartuar nga Kryesia, lidhur me këtë çështje.

Fatmir Sejdiu, në emër të Kryesisë, e paraqiti Projektdeklaratën si vijon:

Kuvendi i Kosovës

Duke u mbështetur në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovës, kreu 1, nenet 1.2 dhe 1.4, si dhe kreu i 9, nen 1.26, në seancën e mbajtur më 22 dhjetor 2003, miraton këtë

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi i Kosovës i deklaron jokushtetuese dhe të papranueshme zgjedhjet e organzuara nga Serbia në territorin e Kosovës dhe si provokim të rëndë për institucionet e Kosovës, qytetarët e saj dhe për institucionet ndërkombëtare në Kosovë;
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga UNMIK-u që t'i parandalojë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, të cilat paraqesin ndërhyrje flagrante në jetën institucionale të Kosovës, si dhe i tensionojnë raportet e përgjithshme në Kosovë;
3. Kuvendi i Kosovës i fton qytetarët e përkatësisë etnike serbe në Kosovë të mos bien pre e manipulimeve dhe të instrumentalizimeve negative politike, të drejtuara jo vetëm kundër interesave të Kosovës, por edhe të vetë komunitetit serb në Kosovë.

Kryetari e hodhi në votë këtë Projektdeklaratë dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- të gjithë;
Kundër-----asnjë;
Abstenime-----asnjë.

Kryetari konstaoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi deklaratën e mësipërme.

Kryetari e deklroi të mbyllur seancën plenare në orën 10:45 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat Daci